

FJALA E DEPUTETES ERISA XHIXHO

E HËNË 23 MAJ 2022

E nderuar Kryetare Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa dyshim, pas një seance shumë të gjatë, me diskutime shumë të detajuara për aktin që po diskutojmë sot, për një prej pasurive më të çmuara kulturore e historike të vendit tonë, pasuri që, fatkeqësisht, po kalon në një koncesion, sepse shteti ka hequr dorë nga menaxhimi i pasurive publike. Ky është thelbi i debatit sot. Çfarë roli ka shteti në menaxhimin e pasurive publike? Duam ne që shteti t'i japë me koncesion pasuritë publike, siç kemi parë në të kaluarën, apo PS-ja, si një forcë e majtë duhej ta konsiderojë shtetin me një rol thelbësor në menaxhimin e pasurive publike, por edhe më tej në shërbimet publike?

Ky parlament miraton sot një tjetër koncesion. Këtu nuk ka gjë për t'u çuditur! Është e njëjta qeveri që vetëm dy vjet më parë, pas muajsh të tërë protestash të artistëve dhe qytetarëve, shembi pabesisht Teatrin Kombëtar, që ishte identiteti i Tiranës, në terrin e natës në mes të pandemisë; rrafshoi një pjesë të historisë së kryeqytetit për t'u dhënë hapësirë ndërtimi klientëve të vet, sepse para etjes për para, trashëgimia kulturore dhe historia për këtë qeveri janë asgjë. Ky parlament miraton sot një tjetër koncesion, sepse kjo qeveri ngre duart lart, kur bëhet fjalë për të ruajtur trashëgiminë historike. Nuk ka para për Butrintin, në një kohë kur nga buxheti i shtetit rrjedhin miliona euro për pagesat e inceneratorëve fantazmë. As kjo nuk është gjë e re.

Buxheti është bujar me disa, por dorështrënguar me disa të tjerë. E këta të fundit janë gjithmonë shtresat në nevojë dhe shërbimet e shtetit për një jetë dinjitoze. Ky parlament miraton sot një tjetër koncesion. Ky ligj ka mbërritur në këtë sallë përmes të njëjtës rrugë, si të tjerët para tij: me mungesën e konsultimit të gjerë publik dhe injorimin e opinionëve të profesionistëve shqiptarë, të cilët e njohin më mirë se kushdo tjetër këtë pasuri të paçmueshme të Shqipërisë. Të nderuar kolegë deputetë, Jo pa qëllim i parashtrova kësaj qeverie qasjen për miratimin dhe konsultimin publik. Nuk janë konsultim publik dy javë me qytetarët. Absolutisht jo. Për një ligj kaq thelbësor, që ka këtë ndjeshmëri publike, do të duheshin 1 apo 2 vjet. Këtë po kërkojmë, pra që i gjithë opinioni publik të sqarohet për të mirat, për benefitet e kësaj marrëveshjeje.

Nuk mund të vazhdojmë me forcën e kartonit për çështje me ndjeshmëri kaq të madhe publike. Këto janë vetëm disa arsye, në një listë të gjatë, pse ky ligj nuk duhet votuar sot, pse nuk mund t'i hapim dritën jeshile një koncesioni të ri, duke i dorëzuar menaxhimin e një pasurie kombëtare, të cilën kemi detyrimin ta bëjmë vetë si shtet. Por, njëkohësisht, këto argumente janë në përputhje me disa pika të rezolutës së miratuar nga Parlamenti Europian për Shqipërinë, disa ditë më parë. Në këtë rezolutë, BE-ja ngre alarmin për nivelin e lartë të korrupsionit në Shqipëri, mosndëshkimin e zyrtarëve të lartë, mungesën e demokracisë, ndryshimet e njëanshme kushtetuese dhe të Kodit Zgjedhor, publikimin dhe keqpërdorimin e të dhënave personale, sulmet ndaj mediave, mungesën e transparencës në tenderët publikë, abuzimin me PPP-të dhe pastrimin e parave.

Këto janë të shkruara e zeza mbi të bardhë mbi një rezolutë të miratuar nga Parlamenti Europian. Janë disa të vërteta që duhet t'i dëgjojmë. Duke u nisur edhe nga ligji që ky parlament miraton sot, nuk mund të mos ndalem në një prej pikave më të rëndësishme të kësaj rezolute: domosdoshmërinë për të përmirësuar demokracinë pjesëmarrëse, duke përfshirë miratimin e një ligji për referendumet. Pse nuk e kalojmë në referendum? Pse kemi frikë ta kalojmë në referendum? Pse nuk miratojmë në një ligj për referendumet që t'u japim të drejtën qytetarëve shqiptarë të shprehin për çështje të ndjeshme për ta? Pse e kemi frikë demokracinë direkte? Kjo është pikëpyetja më e madhe. Kur doni, u referoheni Zvicrës apo vendeve europiane që i çojnë qytetarët e tyre në referendum që të ndërtohet shkolla, kopshti apo të prishet pema? Ky është debati që bëhet në vendet europiane, të cilave u referoheni.

Ky është debati që duhej të ndodhte sot dhe nuk ka këtu pro apo kundër Butrintit. Pa dyshim, të gjithë jemi shqiptarë dhe të gjithë jemi pro zhvillimit të Butrintit, por këtu jemi për ndjeshmërinë që ka kjo pasuri publike dhe se sa qytetarët duhet të bëhen pjesë e gjithë diskutimit dhe informacionit publik. Përballë kësaj maxhorancë, që vë në shënjestër pasuritë e vendit, harton ligje dhe i miraton vetë, ushtrimi i demokracisë direkte mund të sillte një rezultat tjetër. Na tregohet edhe forca e kartonit, pa dyshim. I dimë forcën e kartonit, 74 votat e të tjera me radhë, edhe mënyrën si janë marrë nga kjo maxhorancë, por këtu nuk është debati midis nesh, këtu është debati me opinionin publik. Këtu ka një çështje të ndjeshmërisë së lartë publike, së cilës duhet t'i përgjigjemi.

Jam e bindur se mijëra qytetarë, edhe ata që janë pas kartonëve jeshilë që do të ngrihen këtu sot, nuk janë dakord me koncesionin e Parkut të Butrintit. Kësaj mrekullie arkeologjike nuk mund t'i vëmë çmim. Nuk mund të kërkojmë që dyert e Europës të na hapen, nëse nuk respektojmë, pikë së pari, historinë dhe kulturën tonë dhe nëse nuk dëgjojmë zërin e qytetarëve që na kanë votuar. Kjo është mundësia që

kërkojnë qytetarët që ishin në protestë dhe qytetarët e çdo salle që sot na dëgjojnë nga ekranet. Pse nuk u shty ky debat? Pse nuk u shty kjo marrëveshje?

Ç'është kjo mani e kësaj maxhorancë për të kaluar sa më shpejt ligje, të cilat kanë ndjeshmëri publike, ndërkohë që ligjet që propozon opozita, ashtu sikundër kam propozuar edhe unë në këtë Kuvend, për fëmijët dhe për regjistrin kombëtar të të dënuarve për krimet seksuale dhe shumë projektligje të tjera për heqjen e taksës për karburantet, akcizën etj., nuk miratohen dhe nuk diskutohen në këtë parlament. Ama, kur vijmë për ligje, të cilat ju në mënyrë të rrufeshme doni t'i kaloni, na tregoni forcën e kartonit. Po ju nuk e keni kuptuar që nuk keni thjesht debatin me opozitën, e keni me opinionin publik dhe me ata që na gjykojnë nga kjo sallë, të cilët kemi vendosur t'i përfaqësojmë. Faleminderit!